



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# PJESËMARRJA E KOSOVËS NË MISIONET PAQERUAJTËSE: NJË MJET EFEKTIV PËR POLITIKËN E JASHTME

**Botues:** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Autore:** Donika Marku

**Redaktimi i brendshëm:** Dr. Florian Qehaja dhe Donika Emini

**Redaktimi i jashtëm:** Garentina Kraja

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e partnerëve apo donatorëve të saj.



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**KFOS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

# **PJESËMARRJA E KOSOVËS NË MISIONET PAQERUAJTËSE: NJË MJET EFEKTIV PËR POLITIKËN E JASHTME**

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>5</b>
Të gjeturat kryesore .....	6
<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>KORNIZA E PPSM-SË: BE-JA SI AKTER NDËRKOMBËTAR.....</b>	<b>10</b>
<b>BAZA LIGJORE PËR PJESËMARRJEN E KOSOVËS NË MISIONET PAQERUAJTËSE .....</b>	<b>13</b>
<b>MSA-JA: NJË RRUGË PËR PJESËMARRJE NË OPERACIONET PAQERUAJTËSE .....</b>	<b>16</b>
<b>EKSPERTIZA DHE KAPACITETET E KOSOVËS: ÇKA MUND TË KONTRIBUOJË KOSOVA NË MISIONET PAQERUAJTËSE? .....</b>	<b>20</b>
<b>STRATEGJI ME FITIME TË DYANSHME .....</b>	<b>23</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>25</b>
<b>BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>26</b>

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Izolimi aktual i Kosovës dhe mungesa e rrugës së qartë për anëtarësimin e vendit në organizatat dhe mekanizmat kyçe rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, siç janë Kombet e Bashkuara, NATO, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Bashkimi Evropian, jo vetëm që e kanë penguar vendin për t'u bërë pjesë e infrastrukturës globale të sigurisë, por kanë ulur edhe shanset e Kosovës për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në misionet e ndryshme paqeruajtëse në mbarë botën. Edhe në ato raste kur këto perspektiva duken të mundshme, potenciali i Kosovës për të marrë pjesë në mekanizmat e sigurisë të BE-së nëpërmjet Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë së BE-së, siç është paraparë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, është tkurrur më tej nga refuzimi i pavarësisë së Kosovës nga pesë vendet anëtare të BE-së.

Ky punim shqyrton mundësitë e ofruara nga MSA-ja si një rrugë potenciale për pjesëmarrjen e Kosovës në operacionet dhe misionet paqeruajtëse të BE-së.

# TË GJETURAT KRYESORE

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), në veçanti kapitulli për Dialogun Politik, i ofron Kosovës një momentum që të fillojë dialogun politik për pjesëmarrjen në operacionet dhe misionet paqeruajtëse. Mungesa e konsensusit në BE lidhur me pavarësinë e Kosovës së bashku me faktin se pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën e bëjnë të pamundur që BE-ja të insistojnë në pjesëmarrjen e Kosovës në misionet paqeruajtëse. Prandaj, kjo kërkon një qëndrim më të fuqishëm nga Ministria e Punëve të Jashtme në shtyrjen e një dialogu të politikës në lidhje me këtë çështje.

- MSA-ja i mundëson Kosovës të nis dialogun e politikave për siguri dhe mbrojtje përmes Komitetit të Stabilizim Asociimit. Si përgjigje, qeveria e Kosovës duhet të hartojë dokumente për të lidhur politikën e jashtme të Kosovës me të BE-së, veçanërisht për sa i përket operacioneve dhe misioneve paqeruajtëse.
- Ligjet e Kosovës inkurajojnë pjesëmarrjen e vendit në operacione dhe misione paqeruajtëse. Megjithatë, në përputhje me infrastrukturën aktuale të sigurisë të Kosovës, korniza ligjore rregullon pjesëmarrjen e trupave të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në misione paqeruajtëse, por ligjet nuk adresojnë dërgimin e kapaciteteve civile në operacione të tilla. Për shkak të rritjes së rëndësisë së misioneve civile të BE-së, duhet të hartohet korniza legjislative që rregullon dërgimin në misionet civile. Paralelisht me kornizën ligjore, FSK-ja duhet të vazhdojë trajnimin e saj themelor për operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, kontrollin dhe pastrimin e materialeve të rrezikshme, asgjësimin e armëve dhe eksplozivëve, zjarrfikës dhe detyra të tjera humanitare dhe paqeruajtëse, në mënyrë që të jetë e përgatitur për të shërbyer në operacione dhe misione të tilla.
- Institucionet e Kosovës duhet të theksojnë natyrën teknike të pjesëmarrjes së Kosovës në misionet e Politikës së Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje (PPSM) si mënyrë e tejkalimit të ndarjeve e brendshme të BE-së lidhur me pavarësinë e Kosovës, ashtu siç bëri BE-ja gjatë dislokimit të misionit të PPSM-së, EULEX, në Kosovë.

# HYRJE

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës, marrin pjesë në operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare. Kontributi i tyre zhvillohet në kuadër të Kombeve të Bashkuara, NATO-s, OSBE-së dhe së fundmi këto vende ballkanike marrin pjesë edhe në operacionet paqeruajtëse të BE-së. Përveç kësaj, si kandidatë ose kandidatët potencial për pranim në BE, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar Marrëveshje Kornizë të Partneritetit (MKP) me BE-në. MKP-të institucionalizojnë bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe shteteve të treta në operacionet dhe misionet e PPSM-së.<sup>1</sup> Deri më tani, marrëveshje të tilla janë nënshkruar me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnjën e Hercegovinën. Për më tepër, që nga viti 2004 Shqipëria ka kontribuar në operacionin ushtarak të BE-së në Bosnjë e Hercegovinë (EUFOR ALTHEA), në Misionin e Trajnimit të BE-së në Mali (EUTM Mali) dhe në EUFOR në Çad/RQA. Edhe Maqedonia ka marrë pjesë në EUFOR Althea që nga viti 2004, ndërsa Mali i Zi ka kontribuar në operacionin ushtarak të BE-së kundër piraterisë në Kepin e Afrikës (EU NAVFOR Somali) dhe Misionin Trajnues të BE në Mali (EUTM Mali). Serbia ka marrë pjesë në operacionin ushtarak të BE-së në Republikën e Afrikës Qendrore (EUFOR RCA) që nga viti 2014, në Misionin e Trajnimit të BE-së në Mali (EUTM Mali) dhe EUNAVFOR Atalanta në Somali.<sup>2</sup> Bosnja dhe Hercegovina ende nuk ka marrë pjesë në asnjë mision paqeruajtës të BE-së, megjithatë, forcat e armatosura të vendit kanë marrë pjesë në misione të ndryshme paqeruajtëse të OKB-së dhe NATO-s.<sup>3</sup>

Siç dëshmon kjo përfshirje e vendeve të Ballkanit Perëndimor, kërcënimet globale të sigurisë në zhvillim gjatë viteve të fundit kanë kërkuar një përfshirje më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për vendet që më parë kanë qenë konsumatorë të sigurisë që të kthehen në ofrues të sigurisë,

- 1 Thierry Tardy, "Rishikimi i partneriteteve të sigurisë të BE-së," Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2018. (Qasur më 18 maj 2018), l vlefshëm në <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%201%20Security%20Partnerships.pdf>
- 2 Thierry Tardy, "PPSM: marrja e kontributeve nga shtetet e treta," Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2014. (Qasur më 18 maj 2018), l vlefshëm në [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief\\_6\\_CSDP\\_and\\_third\\_states.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief_6_CSDP_and_third_states.pdf)
- 3 Pierre Minard, Bosnjë dhe Hercegovina: një kontribues i ri në PPSM? Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2016. (Qasur më 18 maj 2018), l vlefshëm në [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Alert\\_12\\_Bosnia\\_FPA.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Alert_12_Bosnia_FPA.pdf)

pjesërisht për shkak të përvojës së tyre me misionet e tilla pas luftërave të viteve 1990 në rajon. Përkundër përvojës së gjatë në misionet paqeruajtëse, nga Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK) tek Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Kosova vazhdon të jetë një përjashtim. Kosova është i vetmi shtet në Ballkanin Perëndimor që nuk merr pjesë në asnjë mision paqeruajtës. Mungesa e pjesëmarrjes e bën të pamundur që Kosova të përfitojë nga angazhimet paqeruajtëse si një mjet i rëndësishëm për avancimin e sigurisë dhe reformave ushtarake.<sup>4</sup> Kjo gjithashtu e pengon Kosovën të bëhet pjesë e një angazhimi global për të ruajtur paqen dhe stabilitetin, si dhe përforcon perceptimin e vazhdueshëm të Kosovës si konsumatore e sigurisë, duke dëmtuar kështu bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të Kosovës në fushën e paqes dhe sigurisë.

Perspektivat e pasigurta të anëtarësimit të Kosovës në organizatat kyçe ndërkombëtare, siç janë OKB, NATO, OSBE apo BE, e kanë kufizuar vullnetin e vendit për të kontribuar në misionet paqeruajtëse. Megjithatë, me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) të nënshkruar mes BE-së dhe Kosovës në vitin 2015, mundësi të reja mund të shfaqen në horizont për Kosovën, pasi dialogu politik mbulon edhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare në çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

Pas përfshirjes së Ballkanit Perëndimor në Strategjinë Globale të BE-së<sup>5</sup>, ku koncepti i reziliencës<sup>6</sup> është një nga prioritetet kyçe të politikës së jashtme të BE-së, Kosova do të përfitonte duke kontribuar në përpjekjet paqeruajtëse, por edhe duke e përdorur si mjet efektiv të politikës së jashtme dhe për vendosjen e marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare në një nivel tjetër - si partner i barabartë në ofrimin e sigurisë.

4 Misionet dhe operacionet paqeruajtëse perceptohen si çelës për përvojat e ndërveprimit për ushtrinë dhe kohët e fundit edhe për përmirësimin e marrëdhënieve civile-ushtarake. Lexoni si e përdori Kroacia paqeruajtjen si mjet për të avancuar reformën e sigurisë dhe reformën e ushtrisë para anëtarësimit në BE: <http://www.providingforpeacekeeping.org/2014/08/13/peacekeeping-contributor-profile-croatia/>

5 "Vizioni i përbashkët, Veprimi i përbashkët: Një Evropë më e fortë, Një Strategji Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian," *EEAS* (2016) (Qasur më 18 maj 2018), [http://eeas.europa.eu/archives/docs/top\\_stories/pdf/euqs\\_review\\_web.pdf](http://eeas.europa.eu/archives/docs/top_stories/pdf/euqs_review_web.pdf)

6 Strategjia Globale e BE-së e shpjegon reziliencën si koncept gjithëpërfshirës që i referohet aftësisë së një shteti për t'u përshtatur në situata të ndryshme të vështira, si mjet për të mbështetur synimet për zhvillimit kombëtar dhe potencialin e shtetit për të përmirësuar dhe ruajtur funksionet kyçe dhe për të menaxhuar mundësitë që i ka apo që do t'i vijnë. Gjithashtu, BE-ja e percepton kushtëzimin e BE-së lidhur me zgjerimin si vendimtar për të rritur reziliencën në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, BE-ja nuk e merr si të mirëqenë reziliencën e këtyre vendeve; prandaj, vazhdimisht përpiqet të promovojë sundimin e ligjit, marrëdhëniet e mira fqinjësore, reformat politike dhe konvergencën ekonomike në këto shtete. Për më shumë rreth mënyrës si e zbrërthen BE-ja këtë koncept, lexoni: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/JOIN\\_2017\\_21\\_f1\\_communication\\_from\\_commission\\_to\\_inst\\_en\\_v7\\_p1\\_916039.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/JOIN_2017_21_f1_communication_from_commission_to_inst_en_v7_p1_916039.pdf)



Meqenëse pjesëmarrja e Kosovës në BE dhe mekanizmat e saj është shumë e ndikuar nga pesë shtete anëtare të BE-së që nuk e njohin Kosovën, ky studim tregon se si MSA-ja mund të rishihet si një mundësi për pjesëmarrjen e Kosovës në misionet paqeruajtëse të BE-së. Studimi gjithashtu analizon kornizën ligjore ekzistuese për pjesëmarrjen e tillë dhe identifikon kapacitetet potenciale dhe fushat e ekspertizës në të cilat Kosova mund të kontribuojë në mënyrë aktive. Andaj, kjo analizë përbën raportin e parë politik të këtij lloji që synon të hedhë themelet e planit të pjesëmarrjes së Kosovës në misionet paqeruajtëse si dhe të përdorimit të këtyre mundësive si mjet për të avancuar qëllimet e politikës së jashtme të Kosovës.

# KORNIZA E PPSM-SË: BE-JA SI AKTER NDËRKOMBËTAR

Globalizimi ka pasur ndikim domethënës në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Sfidat që u paraqitën nga luftërat e viteve 1990 në Ballkan, kërcënimi i terrorizmit të brendshëm dhe krizat e refugjatëve që kanë tronditur Evropën gjatë dy dekadave të fundit, kanë vënë në pah dobësitë kyçe të BE-së për të vepruar dhe reaguar në rajonin e saj. Në shumë mënyra, luftërat në Bosnjë dhe në Kosovë krijuan një momentum që BE-ja të angazhohej për të krijuar një politikë mbrojtëse më efektive dhe më të fuqishme si një mjet për të siguruar rolin e saj të sigurisë ndërkombëtare.<sup>7</sup> Shtetet anëtare e kuptuan nevojën për t'iu përshtatur sfidave të reja të sigurisë dhe një klime të re gjeopolitike.<sup>8</sup>

Teksa sfidat rriten në numër dhe frekuencë, shtetet nuk janë gjithnjë të afta për të mbrojtur popullsinë e tyre, duke rikonfirmuar rëndësinë e organizatave ndërkombëtare të sigurisë, kryesisht OKB-së, si organizata më e madhe multilaterale që vendos misionet paqeruajtëse, dhe NATO-s, si një aleancë ushtarake ndërqeveritare dhe rajonale e dedikuar për paqen, sigurinë dhe mbrojtjen. Këto zhvillime krijuan një ndjenjë urgjence për Evropën që të merrte më shumë përgjegjësi dhe të ndante barrën për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe të paraqiste veten si akter strategjik global.<sup>9</sup> Si rezultat, BE-ja ka zgjedhur ta adresojë këtë kompleksitet duke krijuar Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM).

7 Alistair J.K. Shepherd. "Një moment kyç në historinë e BE-së": Kosova dhe Roli Ndërkombëtar i BE-së", *International Affairs* 85, nr.3 (2009): 513-530, Qasur më 18 maj 2018, [https://www.jstor.org/stable/27695028?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](https://www.jstor.org/stable/27695028?seq=1#page_scan_tab_contents)

8 Mijëvjeçari i ri solli terrorizmin si një kërcënim kyç ndërkombëtar, kërcënime hibride, ndryshime klimatike, paqëndrueshmëri ekonomike dhe pasiguri energjetike, të cilat çuan në konflikte të dhunshme anembanë globit. Lexoni më shumë Micheal Sheehan, 'Ndryshimi i karakterit të Luftës' në Globalizimi i Politikës Botërore: Një hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare, ed. John Baylis, Steve Smith dhe Patricia Owens (Oxford University Press, 2011).

9 Han Dorussen, Emil J. Kirchner dhe James Sperling, 'Ndarja e barrës së sigurisë kolektive në Bashkimin Evropian' *International Organization* 53, nr. 4 (2009): 789-810, qasur më 18 maj 2018, [http://www.jstor.org/stable/40345956?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](http://www.jstor.org/stable/40345956?seq=1#page_scan_tab_contents)

PPSM-ja u krijua në fillim të këtij mijëvjeçari. Ideja u iniciua nga Mbretëria e Bashkuar dhe Franca si mënyrë për të krijuar një ekuilibër të fuqisë në Evropë paralelisht duke ulur ndjeshëm ndikimin e SHBA.<sup>10</sup> Ideja e kësaj ishte që secili shtet anëtar t'i kuptonte kërcënimet dhe veprimet aktuale dhe të ardhshme nën dritën e një perspektive gjeopolitike evropiane, dhe jo vetëm në nivel kombëtar.<sup>11</sup> PPSM-ja e fuqizon BE-në që të marrë një rol udhëheqës në operacionet paqeruajtëse, në parandalimin e konflikteve dhe në forcimin e sigurisë ndërkombëtare. Për më tepër, kompleksiteti i konflikteve bashkëkohore e ka shtyrë BE-në të zhvillojë një sër instrumentesh unike për t'i trajtuar këto sfida, domethënë krijimin dhe zhvillimin e mjeteve civile dhe ushtarake.<sup>12</sup> Stafi për misionet civile dhe ushtarake vjen nga vendet anëtare të BE-së dhe shpenzimet e ndryshme të misioneve ndahen mes shteteve anëtare dhe buxhetit të BE-së. Misionet e tilla janë nën autoritetin e Këshillit Ndërqeveritar të BE-së dhe jo të Komisionit Evropian supranacional.<sup>13</sup> Deri më sot, nga 34 misione dhe operacione të nisura nga BE-ja, 22 kanë qenë civile dhe 11 ushtarake, kurse në Darfur është përdorur modeli i kombinuar.<sup>14</sup>


10 TEREZA SMEJKALOVÁ, "POLITIKA E PËRBASHKËT E SIGURISË DHE MBROJTJES NË PERSPEKTIVËN GJEOPOLITIKE" në Çështjet Strategjike dhe Gjeopolitike në *Botën Bashkëkohore*, ed. Landovsky, Jakub dhe Martin Riegl (Newcastle upon Tyne: Cambridge Scholars Publishing, 2013), 53-69.

11 Christopher Chivvis, *Menaxhimi Civil i Krizave nga BE-ja: Arritjet deri më sot*, (Santa Monica: Rand Corporation, 2010), kap. 2, I vlefshëm në Ebscohost.

12 Në vitin 2017 BE-ja filloi të zbatojë Bashkëpunimin e Përhershëm Strukturor (PESCO), i cili u krijua me Traktatin e Lisbonës. Nevoja e tillë për një politikë më të fuqishme të mbrojtjes e shtyu BE-në të kapërcejë problemin e saj kryesor të financimit të misioneve ushtarake dhe të mundësojë dërgimin e Njërive Ushtarake të BE-së, përmes PESCO-s, si një mjet për të reaguar në mënyrë të pavarur dhe të shpejtë ndaj konflikteve dhe krizave në zhvillim. Për më shumë detaje lexoni "Njësitët ushtarake të BE-së", *EEAS*, 2017, në dispozicion në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/factsheet\\_battlegroups.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/factsheet_battlegroups.pdf)

13 Christopher Chivvis, *Menaxhimi Civil i Krizave nga BE-ja: Arritjet deri më sot*, (Santa Monica: Rand Corporation, 2010), kap. 2, në dispozicion në Ebscohost.

14 "Misionet dhe operacionet e BE-së: Si pjesë e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian (PPSM)," *EEAS*, Në dispozicion në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/csdp\\_missions\\_and\\_operations\\_factsheet.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/csdp_missions_and_operations_factsheet.pdf)



■ Vendet Pjesëmarrëse të BP
 ■ Misionet/Operacionet Ushtarake
 ■ Misionet Civile



**6** misione/operacione ushtarake



**10** misione civile



Më shumë se **5,000** persona të dërguar



Mbajtja e paqës, parandalimi i konfliktëve, forcimi i sigurinë ndërkombëtare, mbështetja e sundimi të ligjit, parandalimi i trafikimit të qenjeve njerëzor dhe piratërisë.

### Misionet dhe operacionet e PPSM-së të Bashkimit Evropian deri në 2018<sup>15</sup>

15 Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm, "MISIONET DHE OPERACIONET E VITIT 2018 TË PPSM-së TË BASHKIMIT EVROPIAN" në Misionet dhe Operacionet e BE-së: Si pjesë e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM) të BE-së, Në dispozicion në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/factsheet-csdp\\_missions\\_and\\_operations\\_05-03-2018.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/factsheet-csdp_missions_and_operations_05-03-2018.pdf)

# BAZA LIGJORE PËR PJESËMARRJEN E KOSOVËS NË MISIONET PAQERUAJTËSE

Republika e Kosovës i konsideron paqen dhe sigurinë kolektive si parime bazë të themeleve të saj. Disa ligje të Republikës së Kosovës i referohen angazhimit të Kosovës për bashkëpunim ndërkombëtar. Për ta kuptuar më mirë bazën ligjore për pjesëmarrjen e Kosovës në misionet paqeruajtëse, është e rëndësishme të shqyrtohet korniza ligjore e tre akterëve kryesorë vendorë, të cilët mund të jenë pjesëmarrës potencialë të misioneve ndërkombëtare të mbështetjes së paqes, përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës dhe Mbrojtja Civile. Korniza ligjore për operacionet paqeruajtëse rregullohet nga një numër i dokumenteve të ndryshme ligjore, duke përfshirë Kushtetutën e Kosovës, ligjin për FSK-në dhe dërgimin e saj jashtë shtetit, ligjet që rregullojnë Policinë e Kosovës, si dhe ligjet që përfshijnë shërbimin civil dhe mbrojtjen civile.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës jep një referencë të përgjithshme për dërgimin e FSK-së jashtë vendit.<sup>16</sup> Gjithashtu, Ligji për FSK-në i referohet pjesëmarrjes në operacionet e reagimit ndaj krizave jashtë vendit si një detyrë kryesore e FSK-së, duke përfshirë edhe operacionet për mbështetjen e paqes.<sup>17</sup> Përveç kësaj, Ligji për dërgimin e FSK-së jashtë vendit në mënyrë specifike përshkruan procedurat për dërgimin e FSK-së jashtë shtetit.

Ky ligj kyç trajton në mënyrë specifike çështjen e pjesëmarrjes në misionet e mbështetjes së paqes, procedurat e dërgimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave që marrin pjesë në misione jashtë vendit. Neni 6 për 'Dërgimi i kontingjentit të FSK-së jashtë vendit' liston si dërgim jashtë vendit operacionet e mbështetjes së paqes, operacionet humanitare si dhe trajnimet e ushtrimit. Rrjedhimisht, "Dërgimi i kontingjentit të FSK - së në operacionet në mbështetje të paqes bëhet mbi bazën e marrëveshjeve me shtetin pranues, me ftesë të ndon-

16 Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008. I disponueshëm në <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

17 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-046 PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS, Prishtinë, mars 2008. I disponueshëm në <http://mksf-ks.org/repository/docs/Law%20on%20KSF%20-%20Albanian.pdf>

jë organizate ndërkombëtare, apo me ftesë të ndonjërit nga shtetet anëtare të organizatave ndërkombëtare të sigurisë, si dhe me ndonjë Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara”.<sup>18</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës inicion dërgimin jashtë shtetit dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës merr vendimin. Ndërkaq, Presidenti i Kosovës autorizon dërgimin. Sipas nenit 15 të këtij ligji, fondet për përgatitjen, pajisjet dhe dërgimi sigurohen nga buxheti i Kosovës. Për shkak të faktit se misionet civile të BE-së përbëjnë mjetin më të rëndësishëm të misioneve paqeruajtëse, krahasuar me misionet ushtarake, është thelbësore të shqyrtohet baza ligjore për pjesëmarrjen e nëpunësve civilë në misionet e tilla.

Ligji për Policinë e Kosovës u lejon zyrtarëve policorë të shërbejnë në misionet paqeruajtëse. Neni 9 i Ligjit për Policinë i referohet bashkëpunimit ndërkombëtar të Policisë së Kosovës: “Policia mund të dërgoj zyrtarë policorë në shërbim të përkohshëm në një organizatë tjetër policore ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin në fuqi ose në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.”<sup>19</sup> Përveç kësaj, një zyrtarët policor mund të caktohet në detyrë jashtë shtetit si pjesë e detyrës së vet të rregullt në mbështetje të bashkëpunimit me autoritetet ndërkombëtare ose organizatat ndërkombëtare.<sup>20</sup> Megjithatë, ligji kryesor që rregullon të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve të administratës publike, që në këtë rast përfshin edhe anëtarët e FSK-së dhe Policinë e Kosovës, nuk ka paraparë mundësinë e dërgimit në misionet e mbështetjes së paqes ose ndonjë mekanizmi tjetër të lidhur.

18 Kuvendi i Kosovës, LIGJI Nr. 04/L-177, PËR DËRGIMIN E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS JASHTË VENDI, f. 2 Prishtinë, maj 2013. I disponueshem në [http://mksf-ks.org/repository/docs/Ligji\\_per\\_dergimin\\_e\\_FSK-se\\_jashte\\_vendit-alb\\_\(shqip\).pdf](http://mksf-ks.org/repository/docs/Ligji_per_dergimin_e_FSK-se_jashte_vendit-alb_(shqip).pdf)

19 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-076 PËR POLICINË, f. 4 Prishtinë, mars 2012. I disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

20 Po aty.

Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës lejon transferimin e përkohshëm të nëpunësve civilë në një organizatë ndërkombëtare. Sipas këtij ligji, një nëpunës civil, me pëlqimin e ndërsjellë, mund të transferohet në një organizatë ndërkombëtare për një delegim që kërkon shkathtësi specifike dhe përvojë të caktuar profesionale.<sup>21</sup> Megjithatë, ky ligj nuk jep referencë të veçantë për dërgimin në misionet e mbështetjes së paqes ose ndonjë mekanizëm tjetër të lidhur. Meqenëse mbrojtja civile është element i rëndësishëm i paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, është e rëndësishme të vlerësohet nëse Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e Tjera<sup>22</sup> i referohet kontributit të Kosovës në këtë aspekt. Neni 8 i këtij ligji i referohet bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Për më tepër, ligji parasheh se një bashkëpunim i tillë duhet të ndodhë sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe veçanërisht me vendet e rajonit.<sup>23</sup>

Vërehet se korniza ligjore është më e detajuar sa i përket rregullimit të pjesëmarrjes së trupave të FSK-së në misionet paqeruajtëse. Dokumentet kyçe strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes i japin rëndësi të madhe pjesëmarrjes në operacionet dhe misionet për mbështetjen dhe ofrimin e paqes, mirëpo nuk përmendin kapacitetet civile për këto operacione dhe misione.

---

21 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Prishtinë, maj 2010. I disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2679>

22 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-027 PËR MBROJTJEN NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA, Prishtinë, TETOR 2011. I disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2775>

23 Po aty.

# MSA-JA: NJË RRUGË PËR PJESËMARRJE NË OPERACIONET PAQERUAJTËSE

Në vitin 2015 BE-ja dhe Kosova nënshkruan MSA-në. Kjo marrëveshje shënoi marrëdhënien e parë kontraktuale mes BE-së dhe Kosovës.<sup>24</sup> Edhe pse MSA-ja perceptohet kryesisht si një marrëveshje ekonomike, Titulli III i kësaj marrëveshjeje ofron një mundësi për forcimin e bashkëpunimit për paqe dhe siguri mes BE-së dhe Kosovës. Prandaj, MSA-ja ofron një mundësi që Kosova gradualisht të transformohet nga një konsumator i sigurisë në një ofrues të sigurisë.

Dialogu politik synon të zgjerojë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin mes BE-së dhe Qeverisë së Kosovës. Ky dialog duhet të udhëheqë rrugën për krijimin e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit mes këtyre dy palëve.<sup>25</sup> Dispozitat e nenit 11 u bëjnë thirrje palëve të promovojnë pjesëmarrjen e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare demokratike, avancimin e perspektivës evropiane të Kosovës dhe ‘afrimin’ me BE-në, rritjen e konvergjencës me Bashkimin Evropian si dhe bashkëpunimin rajonal. Krahas kësaj, neni 14 i MSA-së e autorizon Kosovën që të iniciojë dialogje politike dhe të politikave nëpërmjet Këshillit të Stabilizim-Asociimit (KSA) përmes takimeve apo ndonjë kanali tjetër të duhur mes palëve.<sup>26</sup>

*“Dialogjet politike dhe dialogjet për politika në radhë të parë do të bëhen brenda KSA-së, i cili do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për çdo çështje që Palët mund të dëshirojnë t’i adresojnë”<sup>27</sup>*

24 Këshilli i Bashkimit Evropian, 10728/1/15 REV 1 ‘Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër’ Bruksel, 2015. Në dispozicion në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation\\_and\\_association\\_agreement\\_eng\\_0.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf)

25 Po aty.

26 Kuvendi i Kosoves, Ligji Nr.05/L-069 ‘PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT NËNËRMEJT REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOMUNITETIT EVROPIAN TË ENERJISË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR’ Bruksel, 2015.(Qasur me 12 qershor, 2018) <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-069%20sh.pdf>

Po aty.

27 Po aty, f. 13.



Këto dispozita të MSA-së i mundësojnë Kosovës të përmirësojë dhe të kërkojë forma të reja të bashkëpunimit me BE-në. Për më tepër, mënyra të tilla të reja të bashkëpunimit i lejojnë Kosovës që të zgjerojë konsultimet politike me BE-në për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë që do ta sjellin vendin më afër përafrimit të politikave me PPSM-në e BE-së. Teksa operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave dhe misionet për parandalimin e konfliktit janë një mjet kyç i politikës së jashtme, MSA-ja, në veçanti kapitulli për dialogun politik, ofron një pikë kthese për Kosovën që të iniciojë dialog politik për pjesëmarrjen në operacionet dhe në misionet paqeruajtëse.

Misionet dhe operacionet e PPSM-së mund të jenë të hapura për kontributet e shteteve palë të treta që nuk janë pjesë e BE-së. Që nga viti 2004, marrëdhëniet me shtetet palë të treta themelohen përmes Marrëveshjeve Kornizë të Partneritetit (MKP). MKP-të përcaktojnë kornizën ligjore të kontributeve të këtyre vendeve, duke adresuar çështjet e personelit, shkëmbimin e informacionit, përfshirjen në procedurën e vendimmarrjes, si dhe aspektin financiar të operacioneve. Rreth dyzet e pesë shtete jo-anëtare të BE-së kanë marrë pjesë në operacionin e PPSM-së, duke përfshirë vendet që janë anëtarësuar në BE-në prej asaj kohe.<sup>28</sup> Në fakt, nënshkrimi i MKP-ve me BE-në dhe pjesëmarrja në misionet e PPSM-së është kthyer në praktikë për vendet kandidatë të BE-së. Paralelisht me këtë, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar MKP dhe kanë kontribuar në operacionet e PPSM-së. Kjo e bën Kosovën vendin e vetëm në këtë rajon që nuk ka nënshkruar ende një MKP. Kjo kërkon një qëndrim më të fuqishëm nga MPJ në mbledhjet e KSA-së për të nisur diskutimet për vendosjen e një MKP-je me BE-në për misione të tilla, nën dritën e procesit të anëtarësimit në BE.

BE-ja i fton vendet e saj partnere që të përafrohen me pozicionet e BE-së në nisma të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale dhe për çështje të tilla si sanksionet dhe masat kufizuese. Edhe pse **neni 11** kërkon që partnerët të harmonizohen me qëndrimin e BE-së në organizata dhe për çështje të ndryshme ndërkombëtare, dhe Kosova ka ndërmarrë masa ligjore për t'u harmonizuar me sanksionet ndërkombëtare të BE-së,<sup>29</sup> ende nuk është diskutuar koordinimi i Kosovës me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së. Për më tepër, një koor-

28 Thierry Tardy, "PPSM: marrja e kontributeve nga shtetet e treta," Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2014 (qasur më 18 maj 2018), [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief\\_6\\_CSDP\\_and\\_third\\_states.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief_6_CSDP_and_third_states.pdf)

29 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-183 Për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, Prishtinë, 15 prill 2010. (Qasur më 1 qershor 2018), në dispozicion në: <http://www.mfa-ks.net/repository/docs/shqip-256.pdf>.

dinim i tillë nuk është përfshirë në raportin vjetor të Komisionit të BE-së për Kosovën,<sup>30</sup> dhe as nuk u prezantua gjatë takimit të parë të KSA-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së<sup>31</sup> e për harmonizim me PPSM të BE nuk u diskutua as në mbledhjen e dytë të nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të MSA-së.<sup>32</sup>

Një dispozitë kyçe e **nenit 11** thekson se ky dialog synon të promovojë pjesëmarrjen e Kosovës në komunitetin ndërkombëtar demokratik. Ky nen e detyron BE-në të avokojë për pjesëmarrjen e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, çka do ta afronte anëtarësimin e Kosovës në BE. Megjithatë, kjo dispozitë ndiqet nga klauzola “nëse e lejojnë rrethanat objektive”, të cilat janë përfshirë vetëm në versionin e MSA-së të Kosovës. Është e qartë se kjo është bërë për të kënaqur pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, përkatësisht Greqinë, Rumaninë, Qipron, Spanjën dhe Sllovakinë. Për më tepër, kjo klauzolë e pajis BE-në, dhe ato vende në mënyrë specifike, me mundësinë ligjore për të refuzuar mbështetjen për përfshirjen e Kosovës në organizatat ndërkombëtare<sup>33</sup> dhe politika të tilla si PPSM-ja. Mungesa e konsensusit të BE-së për pavarësinë e Kosovës shoqëruar me klauzolën “nëse e lejojnë rrethanat objektive”, dhe fakti që pesë shtete që nuk e njohin Kosovën, e bëjnë të paqartë se deri në çfarë mase Kosova mund të mbështetet tek BE-ja për mbështetje për anëtarësim të plotë në komunitetin demokratik ndërkombëtar. Kjo dispozitë paraqet një kontradiktë, pasi e detyron BE të avokojë për pjesëmarrjen e Kosovës në ON, por njëkohësisht lejon refuzimin e pjesëmarrjes së saj - duke e kufizuar nga e drejta e saj për të kontribuar në operacionet paqeruajtëse.

30 Komisioni Evropian, Dokument i Punës i Stafit të Komisionit “Raporti i Kosovës, Strasburg, 2018. I disponueshëm në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

31 Gëzim Visoka, “Dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe BE-së në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA),” *GIZ*, 2017 (qasur më 22 mars 2018), në dispozicion si skedar pdf.

32 Lexo më shumë rreth temave të diskutimit të këtij takimi këtu: <http://www.mei-ks.net/sq/lajmet/kosova-dhe-bashkimi-evropian-mbajtn-takimin-e-dyt-t-nn-komitetit-pr-drejtisi-liri-dhe-siguri-t-marrveshjes-s-stabilizim-asociimit->

33 Gëzim Visoka, “Dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe BE-së në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA),” *GIZ*, 2017 (qasur më 22 mars 2018), në dispozicion si skedar pdf.

Paralelisht me këtë, Titulli III i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit specifikon bashkëpunimin rajonal të Kosovës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke hapur një rrugë tjetër për të forcuar rolin e vendit për misionet e ardhshme të sigurisë. **Neni 16** i MSA-së thekson se, “Në përputhje me zotimet e saja sipas nenit 5 dhe 13 si dhe zotimet për paqe dhe stabilitet ndërkombëtar e rajonal dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Kosova duhet në mënyrë aktive të promovojë bashkëpunimin rajonal” dhe BE-ja përmes instrumenteve të asistencës mund t’i përkrah këto përpjekje.<sup>34</sup> Ky nen lidhet me të drejtën e Kosovës për të filluar bisedimet për bashkëpunim rajonal me vendet që tashmë kanë nënshkruar një MSA me BE-në. Për më tepër, ky nen i referohet drejtpërdrejtë bashkëpunimit rajonal në fushat që kanë të bëjnë me lirinë, sigurinë dhe drejtësinë.<sup>35</sup> Gjithashtu, neni 18 i bën thirrje Kosovës që të vazhdojë bashkëpunimin rajonal me shtetet që kanë nënshkruar Procesin e Stabilizim-Asociimit (PSA), ndërsa neni 19 rregullon bashkëpunimin me vendet candidate që nuk janë të përfshira në PSA.

---

34 Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.05/L-069 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMEJT REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NË NJËRËN ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOMUNITETIT EVROPIAN TË ENERJISË ATOMIKE, NË ANËN TJETËR”, p.14 Bruksel, 2015. Në dispozicion në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-069%20sh.pdf>

35 Po aty.

# EKSPERTIZA DHE KAPACITETET E KOSOVËS: ÇKA MUND TË KONTRIBUOJË KOSOVA NË MISIONET PAQERUAJTËSE?

Korniza ligjore e pajis Kosovën me bazën ligjore për të marrë pjesë në misionet dhe operacionet paqeruajtëse. Për më tepër, MSA-ja qartazi hap një mundësi për përafrimin e Kosovës me PPSM-në e BE-së dhe qëllimin e saj themelor për pjesëmarrjen në misionet paqeruajtëse. Pjesa tjetër e këtij raporti të politikës do të paraqes ekspertizën dhe kapacitetin të Kosovës për të kontribuar në mënyrë aktive në misionet paqeruajtëse.

Institucionet e sigurisë në Kosovë kanë një përvojë të madhe me misionet dhe organizatat ndërkombëtare. Kosova ka pritur misionin më ambicioz civil, dhe misionin e parë të integruar<sup>36</sup> të ndërmarrë nga BE-ja. Përveç kësaj, për më shumë se një dekadë Kosova ishte protektorat ndërkombëtar dhe shumë nga institucionet e saj u formuan nga prania dhe puna e përbashkët me misionin e OKB-së në Kosovë dhe forcën paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO, KFOR. Kosova jo vetëm që është e vetëdijshme për pikat e forta, por ka zgjeruar edhe njohuritë për mangësitë dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim në misionet e tilla. Përveç kësaj, Kosova mund të dërgoj staf në misione të sundimit të ligjit, në misionet policore, misionet e monitorimit dhe ekipet e reagimit civil.

Duke qenë se misionet policore të BE-së përbëjnë numrin më të lartë të misioneve civile të BE-së,<sup>37</sup> është e rëndësishme të kuptohet nëse Policia e Kosovës është e gatshme të marrë pjesë në misione të tilla. Është shumë e rëndësishme të theksohet se Kosova ka nënshkruar

36 EULEX ishte misioni i parë i integruar me stafin për policinë, sundimin e ligjit, patrullimin doganor dhe kuftar. Lexoni kapitullin e Chivvis për EULEX-in në Kosovë. Christopher Chivvis, *Menaxhimi Civil i Krizave nga BE-ja: Arritjet deri më sot*, (Santa Monica: Rand Corporation, 2010): 31-42, l vlefshëm nga Ebscohost

37 Deri më sot, misionet policore dallohen si misionet më të rëndësishme civile të BE-së; për më tepër, BE-ja ka vendosur më shumë misione policore sesa çdo lloj misioni tjetër. Gjithashtu, ka dërguar më shumë këshilltarë policorë sesa çdo lloj tjetër personeli. Po aty.

marrëveshje me Agjencinë e Rojeve Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX)<sup>38</sup> dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit (EUROPOL)<sup>39</sup>. Për më tepër, ka hapësirë për shkëmbim dhe pjesëmarrje të Policisë së Kosovës në misionet policore të BE-së, qoftë me praninë statike (EUROPOL) ose me praninë e përkohshme në kufi (FRONTEX).

Marrëveshja ndërmjet FRONTEX dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme është e hartuar në mënyrë të tillë që bën thirrje për bashkëpunim dhe ndërvëprim, duke njohur rëndësinë e Kosovës përtej aktiviteteve të drejtpërdrejta të menaxhimit të kufijve, d.m.th. në shkëmbimin e informacionit dhe analizën e përbashkët të rrezikut. Si detyra kryesore Frontex liston asistencën për shtetet e Shengenit që kërkojnë “ndihmë të shtuar teknike dhe operacionale në kufijtë e jashtëm (p.sh: emergjencat humanitare dhe shpëtimi në det ose kur përballen me presione joproporcionale në kufijtë e tyre)”<sup>40</sup> dhe zhvillimin e një aftësie të shpejtë re-agimi. Marrëveshja parasheh që Kosova mund të marrë pjesë në misionet e tilla paqeruajtëse përmes agjencisë.

Një aspekt i rëndësishëm është se statusi ligjor i marrëveshjes mes FRONTEX dhe Kosovës thekson se kjo marrëveshje nuk është as një traktat ndërkombëtar, as përbushje e detyrimeve ndërkombëtare nga BE-ja apo Kosova, çka thekson aspektin teknik të kësaj marrëveshjeje. Një model i tillë që thekson natyrën teknike të këtyre misioneve mund të shërbejë si kornizë e mirë për të avancuar pjesëmarrjen e Kosovës në misionet paqeruajtëse të BE. Këto dy marrëveshje janë një pikë e rëndësishme fillestare nga e cila Kosova mund të ndërtojë bashkëpunimin e saj të sigurisë me BE-në. Në përputhje me këtë, Kosova mund të dërgojë pjesëtarë të policisë, por edhe këshilltarë të politikave, staf të inteligjencës dhe ekspertë të sigurisë në misionet jashtë vendit. Ngjashëm me gatishmërinë e Policisë së Kosovës, edhe gatishmëria e FSK-së për të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse të BE-së është e rëndësishme.

38 Frontex, “Marrëveshja e punës për krijimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (Frontex) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës”, 2016, qasur me 12 qershor, 2018, [https://frontex.europa.eu/assets/Key\\_Documents/Working\\_Arrangements/WA\\_with\\_Kosovo.pdf](https://frontex.europa.eu/assets/Key_Documents/Working_Arrangements/WA_with_Kosovo.pdf)

39 Më 13 dhjetor 2017, Europol e vendosi Kosovën në listën e partnerëve prioritarë për bashkëpunim strategjik. Marrëveshjet strategjike janë të kufizuara në shkëmbimin e inteligjencës së përgjithshme, si dhe të informacionit strategjik dhe teknik. Kjo marrëveshje pritet të zbatohet në qershor të vitit 2018. Mund ta lexoni këtu <https://www.europol.europa.eu/partners-agreements>

40 (Komisioni Evropian, “Propozim për RREGULLORE TË PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT për Rojet Kufitare dhe Bregdetare Evropiane dhe që shfuqizon Rregulloren (EC) Nr. 2007/2004, Rregulloren (EC) Nr 863/2007 dhe Vendimin e Këshillit 2005/267/EC, Përmbledhjen mund ta lexoni këtu <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=LEGISSUM:133216&from=EN>

Deri më tani, FSK-ja ka kontribuar me ekspertizën e saj në operacionet rajonale, çka shërben si dëshmi për gatishmërinë e saj për të marrë pjesë në misione paqeruajtëse. Pjesëmarrja e FSK-së në misionet më të gjera ndërkombëtare do të jetë e kufizuar për disa kohë, për shkak të mungesës së një plani të qartë të anëtarësimit në organizatat kyçe ndërkombëtare. Derisa FSK-ja nuk ka marrë pjesë në ndonjë mision paqeruajtës, ajo ka organizuar dhe ma marrë pjesë në trajnime që e kanë pajisur me një kuptim të misioneve të tilla.

Duhet të theksohet se në korrik të vitit 2013, NATO shpalli plotësimin e aftësive operacionale të FSK-së, çka e bën FSK-në të aftë për të kryer detyrat që i janë caktuar sipas mandatit të saj.<sup>41</sup> Vendosmëria dhe gatishmëria e FSK-së për të marrë pjesë në operacionet/misionet paqeruajtëse reflektohet në dërgimin e kontingjenteve të saj në Shqipëri në vitin 2010. Në vitin 2010, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dërgoi kontingjente në Shkodër, Shqipëri, për të ndihmuar me situatën emergjente gjatë përmbajtjeve.<sup>42</sup> Për më tepër, njësitë e kërkimit dhe shpëtimit të FSK-së u treguan shumë të aftë në realizim e detyrave të tyre. Njësitë e FSK-së kanë marrë lëvdata në fushat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, çminimit dhe menaxhimit të pajisjeve shpërthyes.<sup>43</sup> Një aspekt i tillë tregon se FSK-ja ka zhvilluar kapacitete që do të ishin të dobishme për misionet ushtarake të BE-së. FSK-ja ka ofruar me dëshirë që të dërgoj shërbimet e saj në misionet dhe operacionet paqeruajtëse; megjithatë, ende nuk është ftuar të marrë pjesë.<sup>44</sup> Për më tepër, ofertat e tilla nga Kosova duhet të përfshihen në një strategji të qartë të sigurisë dhe politikës së jashtme të institucioneve të Kosovës në kontekste shumëpalëshe dhe dypalëshe, çka do të tregonte angazhim të qartë që mbështetet nga veprime konkrete.

41 Lexoni njoftimin për shtyp të NATO-s në lidhje me arritjen e Aftësisë së Plotë Operacionale të FSK-së [https://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_101882.htm?selectedLocale=en](https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101882.htm?selectedLocale=en)

42 Përveç shumë trajnimeve të ndjekura nga FSK-ja, në shkurt të vitit 2018 FSK-ja ka kryer trajnimin për "Operacionet Ushtarake". Për më shumë informacion në lidhje me këtë vizitë trajnimi <http://www.mksf-ks.org/?page=1,24,2256#.WucSQ6SFOUk>

43 Në vitin 2010, 109 anëtarë të FSK-së u dislokuan në Shqipëri, për të ndihmuar me situatën emergjente në Shkodër. Lexo më shumë në <http://mksf-ks.org/?page=1,24,253#.WucSmi5uaUk>

44 Të dhënat e mbledhura nga Grupi i Fokusit i QKSS-së me MFSK, i organizuar në Prishtinë, mars 2018

# STRATEGJI ME FITIME TË DYANSHME

Paqja është parim udhërrëfyes në marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme të Kosovës. Andaj, pjesëmarrja e Kosovës në misionet/operacionet paqeruajtëse do të kontribuonte në detyrimin e saj për të mbajtur pjesën e saj të përgjegjësisë për ruajtjen dhe garantimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Përkatësisht, duke qenë se Kosova nuk ka kapacitet për të krijuar një fond ndihme për zhvillim të vendeve në zhvillim dhe për këtë arsye nuk mund të kontribuojë në politikën zhvillimore të BE-së,<sup>45</sup> paqeruajtja do të ishte një nga mundësitë e pakëta që Kosova ka për të kontribuar për paqen dhe sigurinë globale.

Pjesëmarrja e Kosovës në operacionet dhe misionet e BE-së do të rriste profilin e saj ndërkombëtarisht, duke u përshtatur me politikat e jashtme të BE-së, siç parashihet nga MSA-ja. Përveç kësaj, pjesëmarrja e tillë do të rriste profilin dhe njohjen ndërkombëtare të Kosovës nëpërmjet një roli të dobishëm për menaxhimin e krizave që nuk lidhen me interesat kombëtare. Gjithashtu, shtetet e Ballkanit Perëndimor kontribuojnë në misionet e BE-së si pjesë e aspiratave të tyre për anëtarësim në BE.<sup>46</sup> Për më tepër, pjesëmarrja e Kosovës në misionet e tilla është një mjet i rëndësishëm i politikës së jashtme për të avancuar aspiratat euro-atlantike të Kosovës. Teksa ndikimi i Rusisë dhe Turqisë në Ballkan është rritur, është thelbësore që Kosova të mbetet e vendosur në ndjekjen e aspiratave euro-atlantike.

Nga ana tjetër, ndërveprimi i tillë me shtetet partnere, Kosovën saktësisht, do t'i lejonte BE-së të bashkëpunonte me Kosovën dhe të krijonte ose thellonte lidhjet operationale dhe politike. Nga një këndvështrim i BE-së, puna me partnerët përmban dy dimensione kryesore: njëri

45 Politika zhvillimore e BE-së është një politikë themelore e BE-së e cila siguron mbi 50% të ndihmës globale për zhvillim. Para pranimit të tyre, vendet kandidate të BE-së harmonizojnë legjisllacionin e vendit të tyre me këtë politikë të BE-së sipas Kapitullit 30 nga *acquis* i BE-së. Për shembull, në vitin 2013, Maqedonia ka hartuar një Ligj për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Zhvillimor. Lexoni më shumë rreth këtij ligji në punimin e Andreja Bogdanovski-të, "Përgatitjet e Maqedonisë për kontributin civil në operacionet e paqes: Gjëja tjetër e madhe pas tërheqjes nga Afganistani", 2014, <http://regionalsecurityjournal.com/index.php/JRS/article/view/71/46> (Qasur më 22 mars 2018).

46 John Karlsrud, Marko Milosevic, "Përcaktimi i Kapaciteteve Civile të Ballkanit Perëndimor për Operacionet e Paqes", *Journal of Regional Security* 9: 2, (2014), 79-92, l vlefshëm në <http://regionalsecurityjournal.com/index.php/JRS/article/view/63/40> (qasur më 22 mars 2018).

është i lidhur me kapacitetet, ndërsa tjetri është më politik. Sa i përket kapacitetit, partneritetet kontribuojnë në misionet paqeruajtëse të BE-së duke ofruar personelin, asetet dhe ekspertizën që mund t'i mungojë BE-së.<sup>47</sup> Kosova ka një përvojë prej dy dekadash me misionet paqeruajtëse përmes UNMIK-ut, KFOR-it dhe EULEX-it.

Pjesëmarrja e shteteve partnere në PPSM rrit rolin e BE-së si menaxher i krizave. Përfshirja e partnerëve në misionet e PPSM-së mund të shihet si burim i forcimit i vlefshmërisë globale të rolit ndërkombëtar të sigurisë që luan BE-ja. Një partneritet i tillë do t'i ofronte BE-së mundësinë për ta lëvizur këtë aspekt nga një dimension teknik dhe strategjik në atë politik. Vlera e shtuar e partneritetit është gjithashtu se këto partneritete bashkojnë vendet jo anëtare të BE-së, duke krijuar një atmosferë bashkëpunimi dhe respekti.<sup>48</sup> Përveç kësaj, partneriteti me Kosovën do ta paraqiste BE-në si aktor serioz ndërkombëtar, i cili trajton edhe vendet me kompleksitet dhe tensione të larta si Kosova. Ngjashëm, do të shërbente edhe si një mjet për ta mbajtur të hapur perspektivën e Kosovës në BE gjatë një periudhë skepticizmi ndaj BE-së. Gjithashtu, do të nxirrte në pah aspektin politik të MSA-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së, që deri më sot ka mbetur në hije. Pjesëmarrja e Kosovës në misionet dhe operacionet paqeruajtëse do të vërtetonte se BE-ja është e drejtë me të gjitha shtetet që i konsiderojnë paqen dhe stabilitetin si vlerën e tyre thelbësore ndërkombëtare dhe duan të ofrojnë siguri. Duke pasur parasysh rëndësinë e BE-së, shteteve anëtare të BE-së dhe të EULEX-it në formimin e institucioneve të sigurisë në Kosovë, suksemi i BE-së, EULEX-it dhe MSA-së do të dalë në dritë dhe do të konsiderohet plotësisht i suksesshëm vetëm pasi Kosova të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse të BE-së.

Teksa pjesëmarrja e Kosovës në misionet paqeruajtëse është e kufizuar për shkak të ndarjeve të brendshme të BE-së rreth pavarësisë së Kosovës, BE-ja mund t'a kapërcejë kundërshtimin e pesë shteteve anëtare të BE-së duke theksuar natyrën teknike të pjesëmarrjes së Kosovës në misionet e PPSM-së, ashtu siç u bë gjatë sjelljes së misionit të PPSM-së, EULEX, në Kosovë.

47 Pierre Minard, Bosnjë dhe Hercegovina: një kontribues i ri në PPSM? Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2016 (qasur më 18 maj 2018), l vlefshëm në [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Alert\\_12\\_Bosnia\\_FPA.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Alert_12_Bosnia_FPA.pdf)

48 Thierry Tardy, "PPSM: marrja e kontributeve nga shtetet e treta," Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2014 (qasur më 18 maj 2018), [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief\\_6\\_CSDP\\_and\\_third\\_states.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief_6_CSDP_and_third_states.pdf)



## REKOMANDIME

- Ministria e Punëve të Jashtme duhet të përdorë mbledhjet e Këshillit të Stabilizim Asocimit si një mjet kyç për të nisur dhe ndjekur me vendosmëri dialogun e politikave për Pjesëmarrjen e Kosovës në Misionet Paqeruajtëse, siç parashihet nga neni 14 i MSA-së;
- Qeveria duhet të miratojë një Strategji Kombëtare për Pjesëmarrjen e Kosovës në Misionet dhe Operacionet Paqeruajtëse Ndërkombëtare si një mënyrë për të paraqitur perspektivën evropiane të Kosovës dhe për të rritur konvergjencën me masat e PPSM-së, siç parashihet nga neni 11 i MSA-së. Kjo strategji duhet të përmbajë argumente të përgjithshme politike për pjesëmarrjen e Kosovës në operacionet dhe misionet paqeruajtëse, duke theksuar se Kosova merr pjesë në këto misione në përputhje me vlerat dhe interesat e përbashkëta me BE-në;
- BE-ja duhet të konsiderojë përfshirjen e Kosovës në misionet e saja paqeruajtëse, fillimisht përmes një pranije simbolike, duke e parë vetëm përmes këndvështrimit teknik dhe jo politik;
- Qeveria duhet të hartojë një ligj që do të rregullonte dërgimin e rekrutëve në misionet civile të BE-së. Një ligj i tillë do të shmangte çdo paqartësi ligjore që do të shërbente si justifikim për të parandaluar pjesëmarrjen civile të Kosovës në misionet paqeruajtëse.
- Forca e Sigurisë së Kosovës duhet të vazhdojë trajnimet e saj në misionet dhe operacionet paqeruajtëse, me qëllim që të reflektojë përgatitjen dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në misione të tilla, pavarësisht nga statusi i saj i përkohshëm. Kësisoj, BE-ja nuk do të ishte në gjendje ta përdorte mungesën e përgatitjes së FSK-së si justifikim për mospjesëmarrjen e saj në misionet paqeruajtëse të BE-së.

# BIBLIOGRAFIA

Andreja Bogdanovski. "Përgatitjet e Maqedonisë për kontribut civil në operacionet e paqes: Gjëja tjetër e madhe pas tërheqjes nga Afganistani", 2014, *Journal of Regional Security*, 9:2, (2014), 127–144. I vlefshëm në <http://regionalsecurityjournal.com/index.php/JRS/article/view/71/46> (Qasur më 22 mars 2018).

Alistair J.K. Shepherd. "Një moment kyç në historinë e BE-së": Kosova dhe Roli Ndërkombëtar i BE-së", *International Affairs* 85, nr.3 (2009): 513-530, Qasur më 18 maj 2018, [https://www.jstor.org/stable/27695028?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](https://www.jstor.org/stable/27695028?seq=1#page_scan_tab_contents)

Agjencia Europiane për Menaxhimin e Kufijve të Jashtëm-Frontex. "Përmbledhje e Rregullores së Kshillit (KBE) Nr. 2007/2004 duke themeluar një Agjenci Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm." E qasur (June 11, 2018), E vlefshme në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=LEGISSUM:l33216&from=EN>

Christopher Chivvis. *Menaxhimi Civil i Krizave nga BE-ja: Arritjet deri më sot*, (Santa Monica: Rand Corporation, 2010): 5-42, I disponueshëm nga Ebscohost.

"Deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale nga Forca e Sigurisë së Kosovës". NATO, ndryshimi i fundit në 29 korrik, 2013, E vlefshme [https://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_101882.htm?selectedLocale=en](https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101882.htm?selectedLocale=en)

FRONTEX. "Marrëveshja e punës për krijimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (Frontex) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës", 2016 E disponueshme në [https://frontex.europa.eu/asetet/Key\\_Documents/Working\\_Arrangements/WA\\_with\\_Kosovo.pdf](https://frontex.europa.eu/asetet/Key_Documents/Working_Arrangements/WA_with_Kosovo.pdf) Gëzim Visoka. "Dialogu politik mes Kosovës dhe BE-së në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA)," *GIZ*, 2017 (qasur më 22 mars 2018) Në dispozicion si skedar pdf.

Gordan Bosanac. "Profili i Kontributit Paqeruajtës: Kroacia, përditësimi i fundit më gusht 2015, I disponueshëm në <http://www.providingforpeacekeeping.org/2014/08/13/peacekeeping-contributor-profile-croatia/>

Han Dorussen, Emil J. Kirchner dhe James Sperling. 'Ndarja e barrës së sigurisë kolektive në Bashkimin Evropian' *International Organization* 53, nr. 4 (2009): 789-810, qasur më 18 maj 2018, I vlefshëm në [http://www.jstor.org/stable/40345956?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](http://www.jstor.org/stable/40345956?seq=1#page_scan_tab_contents)

John Karlsrud, Marko Milosevic. "Përcaktimi i Kapaciteteve Civile të Ballkanit Perëndimor për Operacionet e Paqes", *Journal of Regional Security* 9: 2, (2014), 79-92, I vlefshëm në <http://regionalsecurityjournal.com/index.php/JRS/article/view/63/40> (qasur më 22 mars 2018).

Këshilli i Bashkimit Evropian, 10728/1/15 REV 1 'Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër" Bruksel, 2015. f. 18, E disponueshme në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation\\_and\\_association\\_agreement\\_eng\\_0.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf)

Komisioni Evropian, "Propozim për RREGULLORE TË PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT për Rojet Kufitare dhe Bregdetare Evropiane dhe që shfuqizon Rregulloren (EC) Nr. 2007/2004, Rregulloren (EC) Nr 863/2007 dhe Vendimin e Këshillit 2005/267/EC", Strasburg, 2015, I vlefshëm në [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/securing-eu-borders/legal-documents/docs/regulation\\_on\\_the\\_european\\_border\\_and\\_coast\\_guard\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/securing-eu-borders/legal-documents/docs/regulation_on_the_european_border_and_coast_guard_en.pdf)

Komisioni Evropian, Dokument i Punës i Stafit të Komisionit "Raporti i Kosovës, Strasburg, 2018. I disponueshëm në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

Komisioni Evropian, "KOMUNIKIMI I PËRBASHKËT PËR PARLAMENTIN EVROPIAN DHE KËSHILLIN: Një përjasje strategjike për paepshmërinë në veprimin e jashtëm të BE-së," Bruksel, 2017, Qasur më 23 maj 2018, I disponueshëm në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/join\\_2017\\_21\\_f1\\_communication\\_from\\_commission\\_to\\_inst\\_en\\_v7\\_p1\\_916039.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/join_2017_21_f1_communication_from_commission_to_inst_en_v7_p1_916039.pdf)

"Kosova dhe Bashkimi Evropian mbajtën takimin e dytë të nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit" <http://www.mei-ks.net/sq/lajmet/kosova-dhe-bashkimi-evropian-mbajtn-takimin-e-dyt-t-nn-komitetit-pr-drejtisi-liri-dhe-siguri-t-marrveshjes-s-stabilizim-asociimit>

Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008, qasur më 23 maj 2018, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-046 PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS, Prishtinë, mars 2008. Në dispozicion në <http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Law%20on%20the%20KSF.pdf>

Kuvendi i Kosovës, LIGJI Nr. 04/L-177 PËR DISLOKIMIN JASHTË SHITIT TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS, Prishtinë, maj 2013. Në dispozicion në [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Ligji\\_per\\_dergimin\\_e\\_FSK-se\\_jashte\\_vendit-alb\\_\(anglisht\).pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Ligji_per_dergimin_e_FSK-se_jashte_vendit-alb_(anglisht).pdf)

Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-076 PËR POLICINË, Prishtinë, mars 2012. Në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Prishtinë, maj 2010. Në dispozicion në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-149-eng.pdf>

Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 04/L-027 PËR MBROJTJEN NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA, Prishtinë, TETOR 2011. Në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, Prishtinë, 15 prill 2010, në dispozicion në: <http://www.mfa-ks.net/repository/docs/anglisht-281.pdf>.

Micheal Sheehan, 'Ndryshimi i karakterit të Luftës' në Globalizimi i Politikës Botërore: Një hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare, ed. John Baylis, Steve Smith dhe Patricia Owens (Oxford University Press, 2011)

"PARTNERËT dhe MARRËVESHJET". Europol, qasur më 23 maj 2018, në dispozicion në <https://www.europol.europa.eu/partners-agreements>

Pierre Minard. "Bosnja dhe Hercegovina: një kontribues i ri në PPSM?" Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2016 (qasur më 18 maj 2018), në dispozicion në [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Alert\\_12\\_Bosnia\\_FPA.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Alert_12_Bosnia_FPA.pdf)

"Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në trajnimin „Operacionet Paqeruajtëse,” Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, qasur më 23 maj, 2018, në dispozicion në <http://www.mkxf-ks.org/?page=1,24,2256#.WusCQ6SFOUk>

Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm. "Misionet dhe operacionet e BE-së: Si pjesë e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së (PPSM)." Qasur më 23 maj 2018, I vlefshëm në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/csdp\\_missions\\_and\\_operations\\_factsheet.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/csdp_missions_and_operations_factsheet.pdf)

Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm. "Grupet luftarake të BE-së." 2017, qasur më 23 maj, 2018, I vlefshëm në [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/factsheet\\_battlegroups.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/factsheet_battlegroups.pdf)

TEREZA SMEJKALOVÁ. "POLITIKA E PËRBASHKËT E SIGURISË DHE MBROJTJES NË PERSPEKTIVËN GJEOPOLITIKE" në Çështjet Strategjike dhe Gjeopolitike në *Botën Bashkëkohore*, ed. Landovský, Jakub dhe Martin Riegl (Newcastle upon Tyne: Cambridge Scholars Publishing, 2013), 53-69, eBook Collection (EBSCOhost), EBSCOhost (qasur më 23 maj, 2018).

Thierry Tardy. "Rishikimi i partneriteteve të sigurisë të BE-së." Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2018. (Qasur më 18 maj 2018), I vlefshëm <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%201%20Security%20Partnerships.pdf>

Thierry Tardy. "PPSM: marrja e kontributeve nga shtetet e treta." Institut i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë, 2014 (qasur më 18 maj 2018) | vlefshëm [https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief\\_6\\_CSDP\\_and\\_third\\_states.pdf](https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief_6_CSDP_and_third_states.pdf)

Të dhënat e mbledhura nga Grupi i Fokusit i QKSS-së me MFSK, i organizuar në Prishtinë, mars 2018

"U kthye Njësia e Kërkim-Shpëtim të FSK-së, nga misioni në Shkodër." Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, qasur më 23 maj, 2018, në dispozicion në <http://mksf-ks.org/?page=1,24,253#.WucSmi5uaUk>

"Vizioni i përbashkët, Veprimi i përbashkët: Një Evropë më e fortë, Një Strategji Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian," *EEAS* (2016) (qasur më 18 maj 2018), I disponueshëm në [http://eeas.europa.eu/archives/docs/top\\_stories/pdf/eugs\\_review\\_web.pdf](http://eeas.europa.eu/archives/docs/top_stories/pdf/eugs_review_web.pdf)



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

341.2(4/9:496.51)

Marku, Donika

Pjesëmarrja e Kosovës në misionet paqeruajtëse një mjet efektiv për politikën e jashtme / Donika Marku. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2018 . – 32 f. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-679-79-4**

ISBN 978-9951-679-79-4



9 789951 679794

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)